

MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE KURBIN

Nr.6303 Prot.

Laç, me 16.12.2019

V E N D I M-SHPALLJE

(Lidhur me ekzekutimin e "Urdherit të Ekzekutimit" të titullit ekzekutiv të debitorit)

Ne Lac, sot me date 16.12.2019

Une, Rovena Prenga, me detyre Përmbaues Gjyqësore pranë Zyres Përmbauese Kurbin, pasi studiova aktet procedurale të çështjes përmbauese Nr.648 rregj. të vitit 2019 bazuar në Urdherin e ekzekutimit Nr.-- prot Dt 17.06.2019 të Prokurorisë së rrethit Gjyqësor Kurbin,

KONSTATOVA:

Se në datë 08.07.2019 është depozituar pranë Zyres së Përmbaimit kërkesa e kreditorit Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin së bashku me "Urdherin e Ekzekutimit" të Titullit Ekzekutiv (vendim gjyqësor) nr.695-109 të datës 25.05.2019, të Gjykates së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me palë dhe objekt:

- Kreditor: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin.
- Debitor: Aurel Fran Gjoka i dtl.19.06.1998 me banim në Gorre.
- Me objekt: Shpenzime procedurale në vlerën 3.000 leke + 360 leke për TFP dhe TVSH e saj.

Nga ana e zyre tona përmbauese kanë filluar procedurat në bazë të nenit 515 e vijues të K.Pr.Civile si dhe ligjit 8730 datë 18/01/2001 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Sherbimit Përmbauesor Gjyqësor" i ndryshuar për ekzekutimin e detyrueshëm të Titullit Ekzekutiv të sipërcituar.

Nga verifikimi i kryer nga ana jone në bashkëpunim me organet kompetente rezultoi se debitori Aurel Fran Gjoka nuk ka marrë dijeni nëpërmjet sherbimit postar, si rezultat i kësaj bazuar në nenin 133/a, 133/b dhe 144/a si dhe 517 të K.Pr.Civile duhet të behet njoftimi me shpallje publike i debitorit lidhur me detyrimin që ai ka ndaj palës kreditore Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkoder për shpenzime procedurale në vlerën 3.000 leke + 360 leke për TFP dhe TVSH-ne mbi këto tarife, gjithsej 560 leke.

Sa me sipër në mbështetje të Nenit 133/a, 133/b dhe 144/a si dhe 517 të Kodit Procedures Civile, ligjit Nr.8730 datë 18/01/2001 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Sherbimit Përmbauesor Gjyqësor", i ndryshuar

V E N D O S A

1-Te kryej njoftimin nëpërmjet shpalljes publike me afat 20 (njëzet) ditë (duke marrë parasysh edhe komunikimin postar) nga data 16.12.2019 – 04.01.2020 të debitorit; Aurel Fran Gjoka i dtl.19.06.1998 me banim në Gorre.

2-Ky vendim përpilohet në disa kopje, ku një kopje afishohet në vendbanimin e fundit të palës debitore, një kopje afishohet në kendin e njoftimeve të kësaj zyre, një kopje dërgohet për afishim në ambientet e Bashkisë Kurbin, një kopje dërgohet për afishim në ambientet e Njesisë Administrative Fushë-Kuqe, një kopje dërgohet për afishim në ambientet e Gjykates së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe një kopje i dërgohet për publikim në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbaimit Tirane.

3-Kjo shpallje publike ka vlerën e aktit të njoftimit për palën debitore; Aurel Fran Gjoka i dtl.19.06.1998 me banim në Gorre.

4-Palë debitore Aurel Fran Gjoka i dtl.19.06.1998 me banim në Gorre, duhet të paraqitet pranë Zyres Përmbauese Kurbin me seli në Lgji nr.4, Lac në katin e parë në ambientet e Gjykates së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe të marrë kontakt me përmbauesin gjyqësor të çështjes përmbauese për t'iu vënë në dispozicion aktet përmbauese, pasi me kalimin e këtij afati do të vijohet me ekzekutimin e detyruar sipas parashikimeve të nenit 519 e në vijim të K.Pr.Civile.

U shpall, sot me datë 16.12.2019.

**PERMBARUES GJYQËSOR
ROVENA PRENGA**

